



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5323/Prot  
1

Tiranë, më 30.9.2021

UDHËZIM

Nr. 20 datë 30.9.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre" dhe vendimit nr. 112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar,

**U D H Ë Z O J:**

1. Në pikën 1, të Kreut IV/A dhe pikën 1, të Kreut IV/B të udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, togfjalëshi "brenda datës 30 shtator", të zëvendësohet me "brenda datës 30 nëntor".
2. Në pikën 1, të Kreut IV/E të udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, togfjalëshi "brenda datës 30 shtator", të zëvendësohet me "brenda datës 31 dhjetor".
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare"

MINISTRI

Evis KUSHI

